



KONTROLLI I LARTË I SHETIT K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

Email: klsh@klsh.org.al, Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 682/13 Prot.

Tiranë, më 29/12/2017

V E N D I M

Nr.203, Datë 29/12/2017

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "CILËSIA E AJRIT"

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 682/4, datë 06.10.2017 realizoi auditimin e performancës me temë "Cilësia e Ajrit". Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Berat, Drejtorinë Rajonale Shëndetësore Berat. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresat nr. 682/5, 6, 7, 8 datë 30.11.2017 iu dërgua projekt-raporti i auditimit institucioneve subjekt auditimi.

Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet e dërguara nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit me shkresë nr. prot. 1500/2, datë 19.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. prot. 682/9, datë 26.12.2017, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. prot/ 1749, datë 29.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. prot. 682/10 dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Qarku Berat, nr. prot. 2028, datë 27.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. prot. 682/11, datë 27.12.2017. Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve ka dërguar observacione me email më datë 29.12.2017.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe *projekt*-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

KONKLUDOVA

Ndotja e ajrit është një çështje shumë e rëndësishme me ndikim jo vetëm social dhe mjedisor, por edhe ekonomik. Në të njëjtën kohë është një problem kompleks i cili parashtron sfida të

shumta në aspektin e menaxhimit dhe reduktimit të substancave ndotëse. Substancat që ndikojnë në cilësinë e ajrit në Shqipëri të përcaktuara nga OBSH¹ dhe direktiva e Cilësisë së Ajrit 2008/50/EC, janë pothuajse të njëjta me ato të vendeve të tjera evropiane. Substancat kryesore që ndikojnë në ndotjen e ajrit në Shqipëri janë: **Lënda e ngurtë pezull (PM₁₀ dhe PM_{2.5}); Dioksidi i sqfurit (SO₂); Dioksidi i azotit (NO₂) dhe oksidet e azotit (NO_x); Benzeni (C₆H₆); Monoksidi i karbonit (CO); Plumbi (Pb); Ozoni (O₃).**

Problemi i Cilësisë së Ajrit në Shqipëri është analizuar pjesërisht në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit e miratuar me VKM 594 datë 10.09.2014 ku tregohen disa nga mangësitë për situatën aktuale të cilësisë së ajrit: ekziston në një farë mase një fragmentizim i përgjegjësive ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) në veçanti sa lidhet me arritjen e objektivave të CAM-it; praktika e tanishme e monitorimit nuk është në linjë me kërkesat e BE-së; kontrolli i shkarkimeve të gazeve nga automjetet është i pamundur të kryhet nga institucionet përkatëse përgjegjëse; kontrolli dhe reduktimi i shkarkimeve të substancave ndotëse nga impiantet industriale nuk mund të arrihet për sa kohë nuk kryhet inspektimi i kontrollit të monitorimit të shkarkimeve industriale nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit; Kontrolli dhe reduktimi i ndotjes së shkaktuar nga industria e ndërtimit është një sfidë e madhe në rastin e Shqipërisë; mungojnë Plani Kombëtar dhe planet lokale për menaxhimin e cilësisë së ajrit; sistemi i inspektimit mjedisor ka një mungesë të kapaciteteve profesionale; mungon një sistem efektiv për ndjekjen penale të thyerjeve të legjislacionit mjedisor; transpozimi i ligjit të krimit mjedisor është një domosdoshmëri për Shqipërinë.

Probleme të tjera që janë evidentuar nga ky auditim janë si më poshtë: qeveria nuk ka të dhëna konkrete mbi pasojat që ka ndotja e ajrit në shëndetin human dhe në mjedis; asnjë analizë nuk është kryer mbi pritshmëritë e politikave të cilësisë së ajrit lidhur me përfitimet ekonomike, sociale e mjedisore.

Aktualisht, vlerat e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk janë reale pasi ato nuk janë gjithëpërfshirëse. Sot, në të gjithë Shqipërinë kemi vetëm 7 stacione monitorimi të cilësisë së ajrit, të cilat monitorojnë pa ndërprerje, por 2 prej tyre për një periudhë 2 vjeçare nuk kanë qenë në gjendje pune. Të gjitha këto stacione janë të pa akredituara, një pjesë e tyre të pakalibruara çka dëshmon qartë për nivelin e ulët të besueshmërisë së të dhënave që ato paraqesin.

Institucionet përgjegjëse për cilësinë e ajrit në vendin tonë janë: **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM); Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit (ISHMP); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP).**

Bashkëpunimi midis institucioneve kryesore si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektoriati shtetëror i Mjedisit e Pyjeve si dhe Instituti i Shëndetit Publik jo gjithmonë ka qenë i frytshëm dhe në nivelet e duhura. Një fakt i rëndësishëm është që Instituti i Shëndetit Publik nuk ka akses në të dhënat e monitorimeve për cilësinë e ajrit që bën Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Sanksionet lidhur me cilësinë e ajrit janë parashikuar në Kodin Penal, në Kreun IV Vepra penale kundër mjedisit, neni 201 Ndotja e ajrit “Ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet”. Në Ligjin nr. 8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, Kreu IX, neni 19 parashikohen gjithashtu sanksionet e ndotësve të ajrit. Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 69 “Kundërvajtjet” parashikon të gjitha rastet në të cilat Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit e Pyjeve mund të marrë dhe të vendosë masa administrative për subjektet që ndotin cilësinë e ajrit. Ligji nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë Kreu VII Kundërvajtjet

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë

Administrative”, është ligji kryesor mbi të cilin Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit e Pyjeve operon shoqëruar gjithashtu edhe bazuar në ligjet e mësipërme.

ISHMP është organi i vetëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit i cili vendos masa administrative kur ato nuk përbëjnë vepra penale ose në raste kur ato përbëjnë vepra penale mund të bëjë kallëzim në prokurori/polici. ISHMP gjithashtu ushtron kontrolle bazuar në kushtet e lejeve të Mjedisit të Tipit A, B dhe C të vendosura nga Agjencia kombëtare e Mjedisit nëse kushtet dhe normat për emetimin dhe shkarkimin e elementëve ndotës në ajër janë respektuar nga subjektet private apo jo.

Auditimi i performancës me temë “Cilësia e ajrit” jep një panoramë të plotë mbi situatën legislative në vend, përafrimin e legjislacionit shqiptar me BE-në dhe gjendjen reale të cilësisë së ajrit në Shqipëri, duke analizuar masat e marra nga institucionet që kanë për detyrë monitorimin, inspektimin dhe raportimin e cilësisë ajrit të mjedisit. Ky auditim u fokusua në parimet e eficiencës dhe efektivitetit i cili ka të bëjë me nivelin në të cilin objektivat e menaxhimit të cilësisë së ajrit të mjedisit janë arritur si rezultat i “*output-eve*”, me qëllim përmirësimin aty ku është e mundur të situatës aktuale në tërësi. Gjithashtu, ky auditim u përqendrua edhe në parimin e eficiencës duke u fokusuar mbi përdorimin optimal ose të dobishëm të burimeve. Në këtë mënyrë kemi pasqyruar një tablo më të qartë midis cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të ofruara nga njëra anë dhe kostos së aktiviteteve dhe burimeve të përdorura për t’i prodhuar ato nga ana tjetër.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi, ***A kanë qenë efektive dhe eficiente masat e marra nga qeverisja lokale dhe qendrore për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe a janë këto masa në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar?*** u arrit në këtë mesazh auditimi:

“Masat e marra nga qeverisja qendrore dhe lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk kanë qenë efektive dhe eficiente. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit (SKCA) e miratuar në vitin 2014, ende nuk është zbatuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA – së. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk është miratuar dhe si rrjedhojë asnjë Bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së. Vlerat e publikuara për Tiranën, ashtu si edhe për qytetet e tjera të Shqipërisë nga stacioni i lëvizshëm i AKM-së nuk janë përfaqësuese si vlera mesatare të tyre. Numri i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse. ISHMP nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit sepse nuk zotëron asnjë mjet/laborator për matjen e këtyre shkarkimeve në terren. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.”

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “***Cilësia e Ajrit***”, të ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Berat, Drejtorinë Rajonale Shëndetësore Berat.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Për Pyetjen: A ka probleme me zbatimin e ligjeve të caktuara dhe nëse po, pse?

Gjetje:

- ✓ Këshilli i Ministrave ende nuk ka miratuar Planin Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit.
- ✓ Asnjë NJVQV në Shqipëri nuk ka miratuar Planin Vendor të Veprimit për cilësinë e ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- Këshilli i Ministrave të miratojë Planin Kombëtar të Veprimit të Cilësisë së Ajrit.
Brenda vitit 2018
- Pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Cilësisë së Ajrit, çdo NJVQV të hartojë dhe miratojë Planet Lokale të Veprimit të Cilësisë së Ajrit.

Pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Cilësisë së Ajrit

Për Pyetjen: Cilat janë detyrimet për informimin e qytetarëve për cilësinë e ajrit nëse ndodh një problem?

Gjetje:

- ✓ AKM ka miratuar Programin e Transparencës në përputhje me Ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 7.
- ✓ Në Programin e Transparencës, Kapitulli III, “Informacion që bëhet publik pa kërkesë”, nuk është reflektuar detyrimi për informimin e qytetarëve nëse ndodh një problem lidhur me cilësinë e ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- AKM të rishikojë Programin e Transparencës duke përfshirë në të informimin e qytetarëve nëse ndodh një problem lidhur me cilësinë e ajrit, në përputhje me Ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 7, pika 1 germa l.

Menjëherë

Për Pyetjen: A kanë qenë efektive politikat për cilësinë e ajrit në Shqipëri dhe çfarë masash përmbajnë ato?

Gjetje:

- ✓ Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit (SKCA) pavarësisht miratimit në vitin 2014, nuk është vënë në zbatim dhe nuk është e shoqëruar me Planin e Veprimit.
- ✓ SKCA nuk ka përcaktuar periudhën e saj të vlefshmërisë.
- ✓ SKCA nuk parashikon asnjë investim shtesë për rritjen e numrit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit.
- ✓ MTM nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA.
- ✓ Kostot totale të cilësisë së ajrit të mjedisit të parashikuara në SKCA janë 594.5 milionë €.
- ✓ Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit vazhdon të jetë i pa akredituar.
- ✓ Shumë laboratorë (për shembull PM₁₀ & PM_{2.5} në dy stacionet e Tiranës) të stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit janë të pa kalibruar.
- ✓ Në Shqipëri numri total i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit është shtatë nga të cilat njëri prej tyre është vetëm për PM₁₀.
- ✓ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit e Pyjeve nuk ka vendosur asnjë gjobë ndaj ndotësve të ajrit në periudhën 2014 - 2016.

Për sa më sipër rekomandoj

- MTM të marrë masa për të vendosur në zbatim Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit.

Menjëherë

- MTM të hartojë dhe të propozojë pranë Këshillit të Ministrave Planin e Veprimit të SKCA.

Menjëherë

- Duke qenë se, SKCA nuk ka të përcaktuar periudhën e vlefshmërisë, MTM të marrë masa për të propozuar këtë pranë instancave përkatëse. Nëse kjo nuk mund të arrihet, atëherë, MTM të hartojë dhe propozojë një strategji të re të përmirësuar për cilësinë e ajrit, ku të jenë përcaktuar qartë afatet kohore të vlefshmërisë së saj dhe analiza kosto përfitim sipas një metodologjie të qartë të përlogaritjes së saj.

Qershor 2018

- Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit, MTM të parashikojë dhe të vendosë si objektiv afat-shkurtër akreditimin/kalibrimin e stacioneve ekzistuese fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit si dhe shtimin e numrit të tyre.

Qershor 2018

- Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të inspektimit të cilësisë së ajrit, MTM të propozojë ndryshime në kuadrin ligjor për diferencimin e ndëshkimit ndaj ndotësve bazuar në nivelin e tejkalimit të pragut të lejuar.

Qershor 2018

Për Pyetjen: A ka tregues për të matur efektivitetin e politikave dhe legjislacionit në luftën ndaj ndotjes së ajrit?

Gjetje:

- ✓ ISHP nuk ka kryer asnjë studim për të vlerësuar impaktin dhe përfitimet shëndetësore nga zbatimi i politikave të cilësisë së ajrit.
- ✓ ISHP nuk ka njohuri mbi kostot dhe përfitimet shëndetësore lidhur me politikat e cilësisë së ajrit.
- ISHP nuk ka asnjë të dhënë mbi treguesit cilësisë ajrit - shëndet të miratuara nga OBSH si për shembull “Vitet e humbura të jetës – *Years of Live Lost*”, “Vitet e jetuara me paaftësi – *Year lived with disability*”.
- Drejtoritë Rajonale Shëndetësore raportojnë në ISHP statistika mbi sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e popullatës, por, me këto ISHP nuk bëjnë lidhjen shkak pasojë midis ndotjes së ajrit dhe impaktin në shëndetin e popullatës.
- ✓ Treguesit e vetëm që përdor MTM lidhur me efektivitetin e politikave të cilësisë së ajrit janë vlerat mesatare vjetore të elementëve kryesorë të ndotjes së ajrit, numri vjetor i ditëve me tejkalim të normës së lejuar.
- ✓ Në Raportet e Gjendjes së Mjedisit AKM nuk pasqyrohet sa përqind e popullatës ekspozohet ndaj ndotjes së ajrit.
AKM nuk ka kryer asnjë vlerësim lidhur me përlogaritjen në terma monetarë të përfitimeve nga politikat e cilësisë së ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- MTM të marrë masa për të propozuar ndryshime në kuadrin ligjor me qëllim kryerjen e analizës kosto-përfitim për çdo politikë dhe legjislacion mjedisor para miratimit të tyre.

Dhjetor 2018 dhe në vazhdimësi

- ISHP të përfitojë njohuri mbi analizën kosto – përfitim të politikave të cilësisë së ajrit dhe ndikimit në shëndet përmes konsolidimit të bashkëpunimeve ndërinstucionale brenda dhe jashtë vendit me institucione kërkimore shkencore homologe duke realizuar dhe duke marrë pjesë në seminare me ekspertë të fushës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

- ISHP të realizojë një studim pilot (duke përfshirë MTM dhe AKM, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë) mbi vlerësimin e impaktit që ka ndotja e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës duke përdorur treguesit cilësi e ajrit - shëndet të miratuara nga OBSH si për shembull “Vitet e humbura të jetës –*Years of Live Lost*”, “Vitet e jetuara me paaftësi -*Year lived with disability*”.

Dhjetor 2018

- AKM të marrë masa dhe të pasurojë Raportin e Gjendjes në Mjedis me të dhëna mbi përqindjen e ekspozuar të popullatës ndaj ndotjes së ajrit.

Për Raportin pasardhës të Gjendjes së Mjedisit

- AKM të përfitojë njohuri mbi analizën kosto – përfitim të politikave të cilësisë së ajrit përmes konsolidimit të bashkëpunimeve ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit me institucione monitoruese homologe duke realizuar dhe duke marrë pjesë në seminare me ekspertë të fushës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

*Për Pyetjen: **A është i koordinuar legjislacioni nëse ka qasje të ndryshme?***

Gjetje:

- ✓ ISHP si institucion kërkimor shkencor jo gjithmonë është ftuar në diskutime lidhur me propozime apo hartimin e politikave të cilësisë së ajrit.
- ✓ Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet nga AKM dhe ISHP.
- ✓ ISHP nuk ka akses në të dhënat e treguesve të cilësisë së ajrit që monitorohen nga AKM.
- ✓ Rregullorja e ISHMP-së nuk parashikon në dispozitat e saj detyra specifike për inspektimin e cilësisë së ajrit.
- ✓ Inspektorët e ISHMP-së nuk e bëjnë dallimin midis veprave penale dhe kundravajtjeve administrative për shkelësit e normave të cilësisë së ajrit në veçanti dhe treguesve të tjerë mjedisorë në përgjithësi.
- ✓ Ligji minerar dhe ligji për lejet e mjedisit² nuk e kanë të përcaktuar distancën midis zonës së shfrytëzimit minerar me zonat e banuara.

Për sa më sipër rekomandoj

- MTM, në cilësinë e institucionit përgjegjës në hartimin e politikave të cilësisë së ajrit, të marrë masa dhe të përfshijë në diskutime ISHP si institucion kërkimor shkencor dhe përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të impaktit mjedis-shëndet.

Në vazhdimësi

- Me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ajrit, AKM të marrë masa që t’i sigurojë ISHP-së akses on line të vazhdueshëm në të gjitha të dhënat e treguesve të cilësisë së ajrit që ajo disponon nga monitorimet e kryera.

Menjëherë

- ISHMP të hartojë dhe të ndryshojë rregulloren e brendshme të funksionimit të saj duke përfshirë detyra specifike për inspektimet e cilësisë së ajrit.

Mars 2018

- Me qëllim qartësimin midis veprave penale dhe kundravajtjeve administrative në mbrojtjen e cilësisë së ajrit, MTM të marrë masa dhe të propozojë ndryshime ligjore përkatëse.

Menjëherë

² Ligji nr 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

- MTM dhe MIE të marrin masa për të propozuar ndryshimet e nevojshme në ligjin për lejet e mjedisit dhe ligjin minerar me qëllim përcaktimin e distancave midis zonave të shfrytëzimit minerar dhe zonave të banuara.

Qershor 2018

Për Pyetjen: Cilat janë burimet e financimit të politikave për cilësinë e ajrit?

Gjetje:

- ✓ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk i ka të përcaktuara shpenzimet buxhetore në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit.
- ✓ Fondi i mjedisit ende nuk është krijuar³.
- ✓ MTM nuk ka parashikuar fonde buxhetore për akreditimin dhe kalibrimin jashtë vendit⁴ të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në vitet 2014 - 2016.

Për sa më sipër rekomandoj

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të përcaktojë dhe të specifikojë në zëra të veçantë shpenzimet buxhetore në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit.

Buxheti i vitit 2019

- Të krijohet fondi i mjedisit në përputhje me Ligj nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 67.

Shtator 2019

- MTM, në bashkëpunim me AKM, të ngrenë një grup pune për të vlerësuar kostot për akreditimin dhe kalibrimin jashtë vendit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Menjëherë

- MTM të veprojë për të kërkuar fondet e nevojshme për akreditimin dhe kalibrimin jashtë vendit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit pranë Ministrisë së Financave.

Qershor 2018

Për Pyetjen: A kanë njohuri institucionet përgjegjëse mbi kostot dhe përfitimet (ekonomike-sociale e mjedisore) e politikave lidhur me cilësinë e ajrit dhe cilat janë këto?

Gjetje:

- ✓ ISHP nuk ka njohuri mbi kostot dhe përfitimet lidhur me politikat e cilësisë së ajrit.
- ✓ AKM nuk ka njohuri mbi kostot dhe përfitimet lidhur me politikat e cilësisë së ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- AKM dhe ISHP si institucione kërkimore shkencore duhet të marrin masa që në vitet e ardhshme të realizojnë analiza kosto - përfitim në sferat ekonomike-sociale e mjedisore. Analizat kosto përfitim duhet të jenë në fokusin dhe në vizionin e tyre duke shoqëruar raportet/studimet që ato prodhojnë me analiza të tilla.

Qershor 2019

Për Pyetjen: A janë vlerësuar kostot dhe përfitimet nga institucionet përgjegjëse?

Gjetje:

- ✓ Raportet e Gjendjes së Mjedisit të viteve 2014, 2015 dhe 2016 nuk reflektojnë përdorimin e analizës kosto-përfitim për të gjithë treguesit mjedisorë dhe në veçanti për cilësinë e ajrit.
- ✓ Shqipëria ka numrin më të vogël⁵ të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në raport me sipërfaqen e saj.

³ Ligj nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 67

⁴ Në Shqipëri nuk ka asnjë subjekt të licensuar për të bërë kalibrimin e laboratorëve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

⁵ Ky krahasim është bërë me të gjitha SAI-t që janë pjesë e këtij auditimi paralel ndërkombëtar.

- ✓ ISHP nuk ka bërë asnjë studim për periudhën 2014-2016 që të vlerësojë përfitimet shëndetësore që supozohen të arrihen nga politikat që kanë patur për qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- MTM të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim eliminimin e inefficiencës dhe inefektivitetit të procesit të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Menjëherë

Për Pyetjen: A është funksional sistemi i monitorimit të cilësisë e ajrit?

Gjetje:

- ✓ Ka mospërputhje midis programeve vjetore të monitorimit të mjedisit⁶ (për kapitullin e ajrit), me Raportet e Gjendjes së Mjedisit (për kapitullin e ajrit).
- ✓ Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (RGJM) 2015, rezultatet e matjeve të kryera nuk përcaktojnë qartë llojin e stacionit (nëse është stacion automatik fiks apo i lëvizshëm, si për shembull stacionet e Korçës, Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit) që ka kryer këto matje⁷.
- ✓ Në RGJM, 2015 nuk specifikohet nëse është zbatuar kriteri i Programit të Monitorimit të Mjedisit 2015 për PM₁₀ dhe PM_{2.5} sa i përket mbulimit të kohës së monitorimit në masën 90 % dhe përfutimit të të dhënave në masën 90%⁸.
- ✓ Përcaktimi i zonave të kampionimit dhe monitorimit të cilësisë së ajrit për periudhën 2014 - 2016 nuk është përshkruar në Raportet e Gjendjes së Mjedisit.
- ✓ Për sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit nuk kryhet kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.
- ✓ Aktualisht në të gjithë Shqipërinë ka vetëm 7 stacione automatike statike të cilët monitorojnë 365 ditë/vit. Stacionet e tjera janë stacione të lëvizshme të cilat monitorojnë në periudha 2 - 3 javore në sezone të ndryshme.
- ✓ Në qytetin e Tiranës, AKM nuk ka stacion automatik fiks të monitorimit të ajrit.
- ✓ ISHMP për periudhën 2014 - 2016 nuk ka kryer inspektime të subjekteve apo operatorëve që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis për cilësinë e ajrit.
- ✓ ISHMP nuk mund të verifikojë tejkalimin e normave pasi mungojnë pajisjet matëse laboratorike për të vlerësuar tejkalimin e shkarkimeve mbi normat e lejuara.
- ✓ Në kundërshtim me Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Neni 24, pika 3, për vitet 2014 dhe 2016 nuk ka hartuar Programin Vjetor të Inspektimeve, nuk e ka dërguar atë për mendim në Inspektoriatin Qendror dhe nuk ka marrë miratimin përkatës nga Ministri i Mjedisit. Ndërsa për vitin 2015 Programi Vjetor i inspektimeve është hartuar dhe është marrë mendimi nga Inspektoriatin Qendror, por ky program nuk është miratuar nga Ministri i Mjedisit.
- ✓ ISHMP nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë Program Vjetor të Inspektimeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016, por kanë dorëzuar vetëm planet e punës të cilat nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimin ligjor.
- ✓ ISHMP nuk respekton normat metodologjike të vendosura nga Inspektoriatin Qendror.
- ✓ ISHMP nuk përdor portalin e inspektime “on line” (e-inspection) pavarësisht faktit se është trajnuar për përdorimin e tij nga Inspektoriatin Qendror. Inspektoriatin Qendror ka shpërndarë 62 paketa portabel për kryerjen e inspektimeve on line të cilat nuk janë përdorur asnjëherë nga ISHMP.
- ✓ ISHMP gjatë kryerjes së inspektimeve nuk përdor “badget” identifikues i cili është lëshuar posaçërisht nga Inspektoriatin Qendror.

⁶ Programi Kombëtar i Monitorimit (PKM) për vitin 2014, fq 3, 4 dhe PKM 2015, fq 18.

⁷ RGJM, 2015, fq. 4, 5 dhe RGJM 2014 fq 16, 17.

⁸ RGJM, 2015, fq 5 dhe RGJM 2014 fq 16, 17.

- ✓ Inspektorët e ISHMP-së jo gjithmonë pajisen me autorizimin përkatës në kundërshtim me metodologjinë e aprovuar nga Inspektoriati Qendror.
- ✓ ISHMP nuk ka kërkuar dhe as nuk i janë akorduar fonde për blerjen e pajisjeve matëse laboratorike.
- ✓ Në planet vjetore të punës së ISHMP-së nuk parashikohet inspektimi i cilësisë së ajrit.
- ✓ ISHMP jo gjithmonë administron dosjet e inspektimit në përputhje me ligjin për arkivat⁹.
- ✓ ISHMP nuk ka krijuar një “data base” të inspektimeve për cilësinë e ajrit.
- ✓ MTM nuk ka transpozuar ende Direktivën Evropiane të ligjit të krimit mjedisor.

Për sa më sipër rekomandoj

- AKM të hartojë Raportet e Gjendjes së Mjedisit në përputhje të plotë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.

Për Raportin e ardhshëm të Gjendjes në Mjedis

- Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit të shoqërohet me kryerjen e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë.

Brenda 2018 dhe në vazhdimësi

- MTM të marrë të gjitha masat e nevojshme për shtimin e numrit të stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në shkallë vendi dhe veçanërisht në qytetin e Tiranës.

Qershor 2019

- ISHMP të miratojë Programin Vjetor të Inspektimeve për vitin e ardhshëm.

Menjëherë

- ISHMP të ndjekë udhëzimet e vazhdueshme nga Inspektoriati Qendror lidhur me metodologjinë e inspektimit, përdorimin e portalit “e-inspection”, përdorimin e “badge” identifikues etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

- Inspektorët e ISHMP-së, gjatë inspektimeve në terren, të pajisen gjithmonë me autorizimin përkatës në përputhje me metodologjinë e aprovuar nga Inspektoriati Qendror.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

- Në planet vjetore të punës, ISHMP të parashikojë inspektimin e cilësisë së ajrit

Brenda 2018 dhe në vazhdimësi

- ISHMP të marrë masa dhe të kërkojë fonde nga MTM për të plotësuar mangësitë që ka në pajisje logjistike si laboratorë matës të treguesve të ajrit etj.

Mars 2018

- ISHMP të respektojë kriteret ligjore për administrimin e dosjeve të inspektimeve në përputhje me ligjin për arkivat.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për Pyetjen: A është efektiv plotësimi i të dhënave dhe përpilimi i raporteve?

Gjetje:

- ✓ Raportimi nuk është i besueshëm.
- ✓ Ka mospërputhje midis Programeve Vjetore të Monitorimit të Mjedisit dhe Raporteve të Gjendjes së Mjedisit.
- ✓ Nuk respektohet dhe nuk përshkruhet saktë metodologjia e ndjekur për raportimin e rezultateve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Për sa më sipër rekomandoj

- Duke qenë se përpilimi i Raporteve të Gjendjes së Mjedisit është pasojë dhe varet nga i gjithë procesi i monitorimit të cilësisë së ajrit, rekomandimi kryesor lidhur me këtë

⁹ Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”

çështje është zbatimi me përpikmëri i Programeve të Monitorimit të Cilësisë së Mjedisit gjatë matjes dhe monitorimit të cilësisë së ajrit të cilat më pas publikohen në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin përkatës.

Dhjetor 2018

Për Pyetjen: A janë të gjitha të dhënat e cilësisë së ajrit në dispozicion të qytetarëve?

Gjetje:

- ✓ Të dhënat e cilësisë së ajrit janë në dispozicion të qytetarëve vetëm në formën e Raporteve të Gjendjes së Mjedisit të cilat janë vjetore.
- ✓ AKM nuk i siguron akses “on line” qytetarëve të Shqipërisë për të patur të dhënat e gjendjes së cilësisë së ajrit në kohë reale (p.sh. çdo 1 orë etj).

Për sa më sipër rekomandoj

- AKM duhet të mundësojë që çdo qytetar të ketë akses në të dhënat e cilësisë së ajrit në Shqipëri në kohë reale si në të gjitha vendet e tjera.

Dhjetor 2018

Për Pyetjen: A ka mekanizma në dispozicion të institucioneve përgjegjëse për të përfituar njohuri për problemet në të ardhmen?

Gjetje:

- ✓ MTM si dhe institucionet e saj në varësi AKM dhe ISHMP janë të varura nga asistenca e projekteve të donatorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- ✓ ISHP nuk disponon mekanizma për të përfituar njohuri për problemet në të ardhmen, si rezultat i mungesës së kapaciteteve infrastrukturore, mos përfshirjes në diskutime ligjshmërie apo dhe dhënies së kompetencave të plota për realizimin e procesit të monitorimit.
- ✓ ISHP është duke bashkëpunuar me Institutin Superior Sanitar Romë dhe përfaqësues të Komisionit Evropian lidhur me vlerësimin e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe nivelit të problemeve shëndetësore të lidhura me këtë cilësi, për të bërë të mundur nxjerrjen në pah të mangësive të këtij sistemi ndotje/shëndet, për të gjetur rrugët e vendosjes së një sistemi monitorimi, vlerësimi dhe parashikues për cilësinë e ajrit dhe nivelin e sëmundshmërisë në të ardhmen.

Për sa më sipër rekomandoj

- ✓ ISHP pas përfundimit të bashkëpunimit me Institutin Superior Sanitar Romë të mundësojë zbatimin e vlerësimit të sistemit ndotje e ajrit-shëndet.

Pas përfundimit të partneritetit me Institutin Superior Sanitar Romë

Për Rastin Studimor: Aktiviteti i Shfrytëzimit të Karrierave Sipërfaqësore në Urën Vajgurore

Gjetje:

- ✓ ISHMP Berat nuk ka vendosur asnjëherë gjoba ndaj subjekteve ekonomike, mjetet e të cilëve qarkullojnë në rrugët e fshatit duke mos respektuar normat përkatëse të sigurisë dhe të mbrojtjes së ajrit.
- ✓ ISHMP Berat nuk ka vendosur asnjë gjobë ndaj subjekteve ekonomike për tejkalim të normave të lejuara të emetimeve në ajër.
- ✓ ISHMP nuk ka inspektuar dhe nuk ka marrë asnjë masë sa i përket rehabilitimit të mjedisit, rrethimit të karrierave sipërfaqësore me bimë dekorative, përdorimin e shihedhësve gjatë shfrytëzimit të tyre etj.
- ✓ ISHMP Berat ka marrë një Vendim për dënim Administrativ me nr. 12 datë 05.09.2014 ndaj subjektit “V Xh” me vlerë 500,000 lekë.

Për sa më sipër rekomandoj

- ISHMP Berat të inspektojë dhe të marrë masa duke ndëshkuar të gjitha subjektet ekonomike, automjetet e të cilave bëhen shkaktarë për ndotjen e ajrit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

- ISHMP Berat të marrë masa dhe të kërkojë fonde nga MTM për të plotësuar mangësitë që ka në pajisje logjistike si laboratorë matës të treguesve të ajrit etj.

Mars 2018

- ISHMP Berat të inspektojë dhe të marrë masa duke ndëshkuar të gjitha subjektet ekonomike të cilat nuk respektojnë kushtin e rehabilitimit të vendosur në Lejen e Mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

- ISHMP Berat të marrë masa dhe të pezullojë aktivitetin e subjektit “V Xh” deri në momentin e pajisjes me Leje Mjedisit.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R